

Shtojca 1: Tabela e Legjislacionit Anti-Diskriminim (Ballkani Perëndimor)

Informacion i përgjithshëm/ Objekti i Ligjit

Juridiksioni	Emri i ligjit	Data e miratimit	Karakteristika të mbrojtura	Objekti personal	Objekti material	Rekomandime
Shqipëria	Ligji për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit	4 shkurt 2010	Gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, moshë, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër.	Të gjithë personat që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë	(Sfera publike dhe private); Punësimi (shpallja e vendeve të lira të punës; rekrutimi dhe përzgjedhja e punëmarrësve; trajtimi i punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi); Edukim, të mira dhe shërbime (mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku; mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun; mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor; sistemimin në një vend ku ofrohet strehim; shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera; shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim; lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim; lehtësi për transport ose udhëtim; shërbimet e profesioneve të lira.)	Të specifikohet që Ligji ndalon diskriminimin për shkak të karakteristikave apo kritereve reale apo të presupozuara; Të përfshihet në objektin material anëtarësimi në organizatat e punëdhënësve dhe organizata profesionale; Të qartësohet kuptimi i “predispozicioneve gjenetike”, te lista që rendit karakteristikat e mbrojtura; Të qartësohet kuptimi i pjesës së mëposhtme të Neni 20(2)(d) në lidhje me të mirat dhe shërbimet: “sistemimin në një vend ku ofrohet strehim”

Bosnjë Hercegovina	Ligji për ndalimin e diskriminimit	28 korrik 2009	Raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, feja, përkatësia etnike, origjina kombëtare ose sociale, lidhja me një pakicë kombëtare, bindja politike apo tjetër, prona, anëtarësimi në sindikata apo shoqata të tjera, edukimi, statusi social dhe gjinia, shprehja apo orientimi seksual, dhe çdo rrethanë tjetër Mungon: aftësia e kufizuar, mosha	Të gjitha organet publike në nivel shteti, entiteti, kantoni dhe Distrikti Brcko i BH, institucionet dhe organet bashkiake, dhe personat juridikë me autoritet publik, si dhe të gjithë personat juridikë dhe fizikë në të gjithë sferat e jetës	(Sfera publike dhe private); Punësimi, Edukimi, Shkenca dhe Sportet, Mbrojtje sociale, mbrojtje për shëndetin, Trajnime, Gjyqësori dhe Administrimi, Strehimi, informim i publikut dhe media; Anëtarësimi në organizata profesionale, Të mira dhe shërbime të përcaktuara për publikun dhe vende publike, Realizimi I sipërmarrjeve, Pjesëmarrje në krijime artistike kulturore, pjesëmarrje e barabartë të të gjithë qytetarëve në jetën publike, Familja, Të drejtat e fëmijëve	Të përfshihet aftësia e kufizuar dhe mosha në listën e karakteristikave të mbrojtura; Të ndalohet diskriminimi për shkak të shoqërimit me ndonjë grup dhe vetëm pakicat kombëtare;
Kroacia	Akti kundër diskriminimit	15 korrik 2008	Raca ose përkatësia etnike apo ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike ose të tjera, origjina kombëtare ose sociale, prona, anëtarësia në sindikata, edukimi, statusi social, gjendja martesore ose familjare, mosha, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, trashëgimia gjenetike, identiteti gjinor, shprehja apo orientimi seksual	Të gjitha organet shtetërore, organet e vetëqeverisjes vendore dhe rajonale, persona juridikë me autoritet publik, të gjithë personat fizikë dhe juridikë	(Sfera publike dhe private); Puna dhe kushtet e punës; akses në vetëpunësim dhe punësim, përfshirë kriteret e përzgjedhjes, kushtet për rekrutimin dhe ngritjen në detyrë; akses në të gjitha llojet e drejtimit profesional, trajnim profesional, përmirësim profesional dhe ritrajnim; Edukimi, Shkenca dhe Sportet; Sigurimet shoqërore, përfshirë mirëqenien sociale, siguracion për pension dhe kujdes shëndetësor dhe sigurimi i papunësisë; mbrojtje shëndetësore; Gjyqësori dhe administrata; Strehimi; Informimi i publikut dhe media; Akses në të mira dhe shërbime dhe sigurimi i tyre; Anëtarësimi dhe aktiviteti në sindikata, organizata të shoqërisë civile, parti politike apo organizata të tjera; Akses në pjesëmarrje në krijimtari kulturore dhe artistike.	Të parandalohet diskriminimi për shkak të shoqërimit me një grup; Të përfshihen specifikisht: kushtet për akses në punësim, largim nga puna dhe pagesë dhe kushtet e punësimit të objekti material; qoftë drejtpërdrejt në Ligj, apo duke iu referuar ligjeve të tjera; Të përkufizohet “trashëgimia gjenetike” në Ligj ose t’i referohet ligjeve të tjera ku mund të gjendet.
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM)	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi	8 prill 2010	Seksi, raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, përkatësia në një grup të marginalizuar, origjina etnike, gjuha, shtetësia, origjina sociale, feja ose besimi, lloje të tjera bindjesh, edukimi, përkatësia politike, statusi social apo personal, aftësia e kufizuar mendore dhe fizike, mosha, gjendja martesore apo familjare, statusi i pronësisë, kushtet shëndetësore apo çdo argument tjetër i përcaktuar në ligj apo të ratifikuar në marrëveshje ndërkombëtare. Mungon: orientimi seksual	Të gjithë personat fizikë dhe juridikë në procesin e ushtrimit të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe legjislati i Republikës së Maqedonisë.	(Sfera publike dhe private); Puna dhe marrëdhëniet e punësimit; edukimi, shkenca dhe sportet; sigurimet shoqërore, përfshirë fushën e mbrojtjes shoqërore, sigurimet për pension dhe aftësi të kufizuar, sigurimet shëndetësore dhe mbrojtjen e shëndetit; gjyqësori dhe administrata; strehimi; informimi i publikut dhe media; akses në të mira dhe shërbime; pjesëmarrje dhe veprimtari në sindikata, parti politike, shoqata të qytetarëve dhe fondacione apo organizata të tjera me pjesëmarrje;	Të përfshihet orientimi seksual në listën e karakteristikave të mbrojtura; Të specifikohet që Ligji ndalon diskriminimin për shkak të karakteristikave ose kritereve reale apo të presupozuara; Të ndalohet diskriminimi për shkak të shoqërimit; Të përkufizohet “përkatësia në një grup të marginalizuar” që renditet

					kultura dhe fusha të tjera të përcaktuara me ligj.	te lista e karakteristikave të mbrojtura; Të hiqet referenca e mëposhtme nga Neni 2: “në procesin e ushtrimit të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe legjisllacioni i Republikës së Maqedonisë”; Të zgjerohet objekti material në lidhje me punësimin në përputhje me Direktivat përkatëse të BE-së për Barazinë;
Mali i Zi	Ligji për ndalimin e diskriminimit	27 korrik 2010	Raca, ngjyra e lëkurës, përkatësia kombëtare, origjina sociale apo etnike, përkatësia me një komb pakicë apo bashkësi kombëtare pakicë, gjuha, feja apo besimi, bindjet politike ose të tjera, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, mosha, gjendja materiale, martesore apo familjare, anëtarësia në një grup ose anëtarësia e presupozuar në një grup, parti politike apo organizatë tjerë, si dhe karakteristika të tjera personale.	Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, për të cilët është i zbatueshëm legjisllacioni i Malit të Zi	Përdorimi i mjediseve/ndërtesave, dhënia e shërbimeve publike, edukimi dhe trajnimi profesional, puna; akses në punësim, punë dhe edukim (kufizuar te argumenti i gjendjes shëndetësore); akses në kujdesin shëndetësor, e drejta për të punuar dhe të drejtat lidhur me marrëdhëniet e punës, e drejta për t’u martuar, krijuar familje dhe të drejta të tjera nga e drejta e martesës dhe marrëdhëniet familjare (kufizuar me argumentin e aftësisë së kufizuar);	Të përfshihet mbrojtja nga diskriminimi për shkak të shoqërimit me cilindo grup (jo vetëm ata të një pakice kombëtare); Të ndryshohen dispozitat e objektit material në përputhje me Direktivat përkatëse të BE-së për Barazinë;
Serbia	Ligji për ndalimin e diskriminimit	26 mars 2009	Raca, ngjyra e lëkurës, paraardhësit, shtetësia, përkatësia kombëtare ose origjina etnike, gjuha, bindjet fetare apo politike, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjendja financiare, lindja, karakteristika gjenetike, shëndeti, aftësia e kufizuar, gjendja martesore dhe familjare, dënime politike, mosha, paraqitja, anëtarësia në një organizatë politike, sindikatë apo tjetër, si dhe karakteristika të tjera personale, reale apo të presupozuara. Mungon: bindja jofetare	Cilido	(Sfera publike dhe private); Procedime para organeve të administratës publike, puna, e drejta për punësim, zgjedhja e lirë e punësimit, rritja në detyrë, rehabilitimi profesional, pagesë e barabartë për punë me vlerë të barabartë, kushte të drejta dhe të kënaqshme pune, pushime të paguara, anëtarësimi në sindikata dhe mbrojtje nga papunësia, dhënia e shërbimeve publike dhe në përdorimin e hapësirave dhe mjediseve publike, edukim dhe trajnim profesional;	Të përfshihen bindjet jofetare në listën e karakteristikave të mbrojtura; Të përkufizohet “paraqitja” siç renditet në listën e karakteristikave të mbrojtura; Të ndalohet diskriminimi për shkak të shoqërimit; Të përfshihen sa më poshtë në objektin material: akses në vetëpunësim apo punësim; anëtarësim në organizata të punëdhënësve dhe ato profesionale si dhe avantazhe sociale dhe strehim.

Kosova ¹	Ligji kundër diskriminimit	19 shkurt 2004	Seksi, gjinia, moshja, gjendja martesore, gjuha, paaftësia fizike apo mendore, orientimi seksual, mendimi apo bindja politike, origjina etnike, kombësia, feja apo besimi, raca, origjina sociale, prona, lindja ose statuset e tjera	Ndërsa Neni 1 u referohet “shtetasve të Kosovës”, Neni 4 flet për “të gjithë personat fizikë dhe juridikë” në lidhje me sektorin publik dhe atë privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimit cenojnë të drejtat e personave fizikë dhe juridikë.	(Sfera publike dhe private); Kushtet për qasje në punësim, vetë punësim dhe të punësimit në profesion, përfshirë këtu kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit; qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvijën e punës praktike; kushtet e punësimit dhe kushtet e punës, përfshirë shkarkimin nga puna dhe pagesën; anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve ose të çdo organizate tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, përfshirë edhe fitimet që mundësohen nga organizatat e tilla; mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore; lehtësitë sociale, përfshirë por pa u kufizuar me ; ndihmën humanitare; arsim; akses në vendbanim dhe gjithë format e tjera të pronës (të luajtshme dhe të paluajtshme); qasje në furnizim e të mirave materiale dhe shërbimeve të cilat janë në dispozicion të opinionit publik; trajtimi i drejtë para gjykatave dhe të gjitha organeve tjera që administrojnë drejtësinë; siguria personale; pjesëmarrje në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhur dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur; qasje në vendet publike; çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjisllacionin në fuqi.	Të specifikohet që ligji ndalon diskriminimin për shkak të karakteristikave apo kriterëve reale apo të presupozuara; Të ndalohet diskriminimi për shkak të shoqërimit; Të rishikohet Neni 1 në lidhje me “parimin e trajtimit të barabartë” të personave të cilët referohen në këtë nen si “shtetas të Kosovës” ² ; Të hiqet referenca e mëposhtme nga Neni 4: “çdo veprim apo mosveprim që shkel të drejtën ose të drejtat”;
---------------------	-----------------------------------	----------------	---	--	--	---

¹ Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionin e statusit të Kosovës dhe është në përputhje me UNSCR 1244/99 dhe Opinionin e GJND-së për deklarimin e pavarësisë së Kosovës.

² Te Rregullorja e UNMIK No. 2004/32, Përfaqësuesi i Posaçëm në atë kohë i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, kur u shpall Ligji, vuri në dukje se fjala “shtetasit” duhet të zëvendësohej me “personat në Kosovë”, dhe se kjo duhej të pasqyrohej në Ligj.

Përkufizime

Juridiksioni	Diskriminim i drejtpërdrejtë	Diskriminim i tërthortë	Ngacmimi	Viktimizimi	Udhëzimi për të diskriminuar	Përshtatje e arsyeshme	Rekomandime
Shqipëria	Diskriminim i drejtpërdrejtë është “ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilëndo [karakteristikë të mbrojtur]”.	Diskriminim i tërthortë është “ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me [karakteristikat e mbrojtura], në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.	Shqetësim është “ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga [karakteristikat e mbrojtura], që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtëruës a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë”.	Viktimizimi është “trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë”.	Udhëzim për të diskriminuar është “një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.	“Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.	Të hiqet referenca: “bazuar në marrëdhënie hierarkike” nga përkufizimi i udhëzimit për diskriminim; Të ndalohet shprehimisht segregimi racor; Të hiqet referenca të Neni 3(5) në lidhje me shqetësimin: “kundërshtim apo mosnënshtrim nga ana e personit të cënuar nga një sjellje e tillë”; Të shprehet në mënyrë specifike se udhëzimi për të diskriminuar do të gjykohej si diskriminim; Të harmonizohet përkufizimi i përshtatjes së arsyeshme me Direktivat e BE-së për Barazinë;
Bosnjë Hercegovina	Diskriminim i drejtpërdrejtë është “çdo trajtim ndryshe për shkak të karakteristikave [të mbrojtura], d.m.th çdo veprim apo mosveprim kur një person apo grup personash vendoset, është vendosur apo mund të vendoset në një pozitë më pak të favorshme, në ndryshim nga një person tjetër apo grup personash në situata të ngjashme”	Diskriminim i tërthortë është “çdo situatë, në të cilën, një dispozitë, kriter apo praktikë, në dukje neutrale, ka ose do të kishte pasojën e vendosjes së një personi apo grupi personash në një pozitë të pafavorshme ose më pak të favorshme krahasuar me persona të tjerë”	Ngacmimi “do të konsiderohet diskriminim në çdo situatë kur sjellja lidhet me një prej argumenteve të përmendura [të mbrojtura] që synon apo ka një pasojë të dëmshmit të dinjitetit të personit dhe krijon një atmosferë, intimiduese, armiqësore, degraduese, poshtëruese ose ofenduese”	“Një person që ka raportuar diskriminimin apo pjesëmarrje në procedim ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi vuan pasojat e këtij raportimi apo pjesëmarrjeje”	“Diskriminim do të konsiderohet edhe udhëzimi për të diskriminuar dhe tjerëve në diskriminim”	“Punëdhënësi, në bazë të nevojave në një rast konkret, merr masat e duhura, me qëllim mundësimin e një personi me aftësi të kufizuara të ketë akses, të marrë pjesë apo të ngrihet në detyrë, dmth të marrë pjesë në trajnim, nëse kjo masë nuk përfaqëson një barrë të paarsyeshme për punëdhënësin”	Të specifikohet që segregimi racor duhet të ndalohet në çdo rast. Të përmirësohet përkufizimi i Diskriminimit të tërthortë duke specifikuar se në rast të justifikimit objektiv, nuk ka diskriminim. Të ndryshohet përkufizimi i viktimizimit për ta harmonizuar me Direktivat e BE-së për Barazinë;

Kroacia	<p>Diskriminim i drejtpërdrejtë është “trajtimi i mbështetur në ndonjë nga argumentet [e mbrojtura] ku një person vendoset, është vendosur apo mund të vendoset në një pozitë më pak të favorshme se sa persona të tjerë në një situatë të krahasueshme”</p>	<p>Diskriminim i tërthortë “quhet se ka ndodhur kur një dispozitë, kriter apo praktikë, në dukje neutrale, e vendos apo do ta vendoste një person në një pozitë më pak të favorshme për shkak të argumentit [të mbrojtur], se sa persona të tjerë në një situatë të krahasueshme, përveç se kur dispozita, kriteri apo praktika mund të justifikohet në mënyrë objektive me anë të një qëllimi të përligjur dhe mjeti i arritjes së këtij qëllimi është i duhur dhe i domosdoshëm”</p>	<p>Ngacimimi është një sjellje e padëshiruar për shkak të ndonjë prej argumenteve [të mbrojtura] me qëllim ose pasojë shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe krijimin e një mjedisi intimidues, armiqësor, degradues ose ofendues.</p>	<p>“Asnjë person nuk duhet të vendoset në një pozitë më pak të favorshme për shkak se ka raportuar, në besim të mirë, rast diskriminimi, ka qenë dëshmitar i diskriminimit, ka refuzuar një udhëzim për diskriminim apo ka marrë pjesë në ndonjë mënyrë në procedime mbështetur në diskriminim, në përputhje me dispozitat e këtij Akti”</p>	<p>“Inkurajimi për diskriminim, nëse kryhet me dashje, gjykohet se përbën diskriminim”</p>	<p>Mosmundësimi i sa më poshtë, për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike, do të gjykohet se përbën diskriminim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i burimeve të disponueshme për publikun, - pjesëmarrje në jetën publike dhe sociale, - akses në vendin e punës dhe kushte të duhura të punës, duke përshtatur infrastrukturën dhe mjediset, duke përdorur pajisje dhe në ndonjë mënyrë tjetër që nuk përfaqëson një barrë të paarsyeshme për personin që është i detyruar ta sigurojë këtë. 	<p>Të harmonizohet dispozita për “përshtatjen e infrastrukturës dhe mjediseve” me formulimin e përdorur te Direktivat e BE-së për Barazinë për përshtatjen e arsyeshme;</p> <p>Të specifikohet se segregimi racor duhet të ndalohet në të gjitha rastet.</p> <p>Të ndryshohet përkufizimi i viktimizimit për ta sjellë në përputhje me Direktivat e BE-së për Barazinë;</p>
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë - FYROM	<p>Diskriminim i drejtpërdrejtë “mbi bazë diskriminuese është çdo veprim, dallim, përjashtim ose kufizim i pavolitshëm që si pasojë e ka ose mund ta ketë pezullimin, shkeljen ose kufizimin e njohjes ose gëzimit të barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në krahasim me trajtimin që e ka ose mund ta ketë një person tjetër në kushte të njëjta ose të ngjashme”.</p>	<p>Diskriminim i tërthortë “mbi bazë diskriminuese është çdo vënie të ndonjë personi ose grupi në pozitë të pavolitshme në krahasim me persona të tjerë, me miratimin e dispozitave, kriterëve të dukshme neutrale, ose me ndërmarrjen e praktikave të caktuara, përveç se kur ato dispozita, kriteret ose praktika, dalin nga qëllimi i arsyeshëm, ndërsa mjetet për arritjen e atij qëllimi janë të duhura dhe të domosdoshme”.</p>	<p>“Shqetësimi dhe veprimi poshtëruës, paraqesin çënim të dinjitetit të personit ose të grupit të personave, që rrjedh nga baza diskriminuese dhe që ka për qëllim ose rezultat çënimin e dinjitetit të personit të caktuar ose krijimin e mjedisit, kërcënues, armiqësor, poshtëruës ose frikësues.</p>	<p>“Sjellja e papërshtatshme ndaj një personi, pësimi i pasojave të dëmshme për shkak se janë ndërmarrë aktivitete të caktuara për mbrojtjen nga diskriminimi (e ka raportuar diskriminim, ka filluar procedurë për diskriminim dhe ka dëshmuar gjatë procedurës).</p>	<p>“Si diskriminim do të konsiderohet edhe çdo aktivitet me të cilin ndonjë person në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë bën thirrje, inkurajon, jep udhëzime ose nxit personin tjetër që të kryejë diskriminim</p>	<p>“Përshtatje e infrastrukturës dhe shërbimeve është marrja e masave përkatëse të nevojshme në rastin e veçantë, që t'i mundësohet personit me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike që të ketë qasje, të marrë pjesë dhe të përparojë në procesin e punës, për sa këto masa nuk imponojnë ngarkesa tejkaluase për punëdhënësit.</p>	<p>Të ndryshohet përkufizimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe atij të tërthortë që të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare;</p> <p>Të zgjerohet objekti i dispozitës përkatëse për përshtatjen e infrastrukturës, me qëllim që të jetë në përputhje me CRPD;</p> <p>Të ndalohet shprehimisht segregimi racor;</p> <p>Të ndryshohet përkufizimi i viktimizimit për ta sjellë në</p>

							përputhje me Direktivat e BE-së për Barazinë;
Mali i Zi	Diskriminim i drejtpërdrejtë “ekziston nëse një person apo grup personash, në situatë të njëjtë ose të ngjashme në krahasim me një person tjetër ose grup personash, sillet apo do të ishte sjellë në një pozicion të pabarabartë, për shkak të një vepre, veprimi apo mosveprimi, bazuar në ndonjë argument [të mbrojtur], përveç se kur vepra, veprimi apo mosveprimi janë të justifikuar në mënyrë objektive dhe të përligjur dhe të arritshme me mjete të duhura dhe të domosdoshme për të arritur atë qëllim, dhe kur janë të pranueshme dhe në proporcion lidhur me qëllimin që dëshirohet të arrihet”	Diskriminim i tërthortë “ekziston nëse një dispozitë në dukje neutrale e një rregulloreje apo akti të përgjithshëm, kriteri apo praktikë, e sjell apo mund ta sjellë një person apo një grup personash në një pozitë të pabarabartë në krahasim me një person tjetër apo grup personash, në bazë të ndonjë argumenti [të mbrojtur], përveç se kur dispozita, kriteri ose praktika janë të justifikuar në mënyrë të arsyeshme nga një qëllim i përligjur dhe i arritshëm me mjete të duhura dhe të domosdoshme për atë qëllim, dhe kur janë të pranueshme dhe në proporcion lidhur me qëllimin që dëshirohet të arrihet.	Ngacmimi , “për ndonjë argument [të mbrojtur], përfaqëson sjellje ose trajtim të një personi, i cili një sjellje apo trajtim të tillë nuk e dëshiron, dhe që ka për qëllim apo përfaqëson shkeljen e dinjitetit personal, dhe shkakton gjendje intimidimi, bezdisje, armiqësore, poshtëruese dhe fyerjeje”	“Askush nuk do të vuajë pasoja negative për raportimin e një rasti diskriminimi, për deponimin para autoriteteve kompetente ose për ofrimin e të dhënave në procedime që hetojnë për një rast diskriminimi”	“ Nxitja apo udhëzimi për diskriminim kundër një personi të caktuar apo grupi personash për cilindo argument [të mbrojtur] gjykohet si diskriminim”	“Diskriminim kundër një personi me aftësi të kufizuara ekziston edhe në rastin kur nuk janë marrë masa të veçanta për të zgjidhur kufizimet apo pozitën e pabarabartë me të cilën përballlet ky person”	Të përshtatet përkufizimi i Diskriminimit të drejtpërdrejtë me legjislacionin e BE-së Të hiqet “bezdisja” si rezultat i mundshëm nga përkufizimi i Ngacimit. Të hiqet referenca “nxitja” për diskriminim. Të ndryshohet përkufizimi i përshtatjes së arsyeshme për ta sjellë në përputhje me standardet ndërkombëtare; Të specifikohet që segregimi racor duhet të ndalohet në çdo rast. Të ndryshohet përkufizimi i viktimizimit për ta sjellë në përputhje me Direktivat e BE-së për Barazinë;
Serbia	Diskriminim i drejtpërdrejtë “ndodh nëse një individ apo grup personash, për shkak të karakteristikave personale të tij/saj, në situatë të njëjtë apo të ngjashme, vendosen ose janë vendosur ose mund të vendosen në pozitë më pak të favorshme nëpërmjet një vepre, veprimi apo mosveprimi”	Diskriminim i tërthortë “ndodh kur një individ apo grup individësh, për shkak të karakteristikave personale të tij/saj apo tyre, vendosen ose janë vendosur ose mund të vendosen në pozitë më pak të favorshme nëpërmjet një vepre, veprimi apo mosveprimi që është në dukje i mbështetur në parimin e barazisë dhe ndalimit të diskriminimit, përveç se kur është i justifikuar me një objektiv të ligjshëm dhe mjetet për arrijten e atij objektivit janë të duhura dhe të domosdoshme”	“Ndalohet ekspozimi i një individi apo grup personash, në bazë të karakteristikave personale të tij/saj ose të tyre, ndaj Ngacimit dhe trajtimit poshtëruës që synon apo përbën shkelje të dinjitetit të tij/saj/tyre, sidomos kur sjell frikë dhe krijon një mjedis armiqësor, poshtëruës dhe fyes”	“Diskriminimi ekziston nëse një individ apo grup personash trajtohet, në mënyrë të pajustificuar, më keq se trajtohen apo do të trajtoheshin të tjerët, vetëm ose kryesisht për shkak se kanë kërkuar apo synojnë të kërkojnë mbrojtje nga diskriminimi, apo për shkak se kanë ofruar apo kanë për synim të ofrojnë të dhëna për trajtim diskriminues”	-	-	Meqenëse nuk është bërë deri më tani, të ndryshohet përkufizimi i Diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe atij të tërthortë që t’i referohet shprehimisht në ligj argumenteve të mbrojtura; Të ndryshohet përkufizimi i Diskriminimit të tërthortë në mënyrë që klauzola që vepra të mbështetet në parimin e barazisë dhe ndalimin e diskriminimit të hiqet; Të ndryshohet dispozita për viktimizimin për të reflektuar legjislacionin e BE-së.

							<p>Të ndalohet shprehimisht segregimi racor;</p> <p>Të përfshihet dispozita për detyrën e përshtatjes së arsyeshme;</p> <p>Të përfshihet përkufizimi i udhëzimit për diskriminim në Ligj dhe të specifikohet që ky udhëzim do të gjykohej si diskriminim;</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

Kosova ³	<p>Diskriminimi i drejtpërdrejtë “nënkuptohej se ka ndodhur kur një person trajtohet, është trajtuar, ose do të trajtohet në mënyrë të pabarabartë në krahasim me tjetrin në një situatë të ngjashme, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e [mbrojtura]”</p>	<p>Diskriminimi i tërthortë “nënkuptohej se ka ndodhur kur një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në shikim të parë e vënë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerë, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e [mbrojtura] përveç në rastet kur dispozita e tillë, praktika apo kriteri mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim dhe me mjete legjitime, të domosdoshme për arritjen e qëllimit”</p>	<p>Ngacimi konsiderohet diskriminim “kur ndodh një sjellje kundër dëshirës (që përfshin por nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike) bazuar në o baza të [mbrojtura], e cila ka për qëllim apo ndikim në shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues dhe fyes, siç është përcaktuar nga ai person”</p>	<p>Viktimizimi konsiderohet diskriminim, dhe “do të konsiderohet se ka ndodhur kur personi përjeton trajtim të hidhur apo pasoja të hidhura si reagim ndaj ankimit apo procedurës, të vëna në lëvizje me qëllim të vënies në jetë të parimit të trajtimit të barabartë ashtu si është përkufizuar te Neni 2 .(a), dhe / ose rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë tjetër në lidhje me ankesën ose procedurën”.</p>	<p>“Udhëzimi për të diskriminuar personat e tjerë, sipas bazave të [mbrojtura], do të konsiderohet diskriminim”.</p>	<p>Të përmendet specifikisht në Ligj përshtatja e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara dhe të përfshihet në listën e përkufizimeve të Neni 3;</p> <p>Të ndalohet shprehimisht segregimi racor;</p>
---------------------	---	---	--	--	---	---

³ Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin e Kosovës dhe përputhet me UNSCR 1244/99 dhe Opinion e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Përfshirjet nga parimi i antidiskriminimit

Juridiksioni	Përfshirje	Veprime pozitive	Kërkesa të vërteta dhe profesionale të domosdoshme	Ethos i bazuar te feja dhe besimi	Kombësia	Rekomandime
Shqipëria	<p>Ndalimi i diskriminimit “nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.</p> <p>Nuk përbëjnë diskriminim “dallimet në shpërblime dhe përfitime”, të vendosura për shkaqet e [mbrojtura], kur “këto dallime janë të arsyeshme dhe në përpjesëtim me një rrezik, i cili vlerësohet në bazë të të dhënave aktuale dhe statistikore të vërtetueshme dhe të lidhura ngushtë me rrezikun”.</p> <p>“Ndalimi i diskriminimit nuk zbatohet për caktimin e një moshe të veçantë për mundësi të përfitimeve sociale, të të mirave, lehtësive dhe shërbimeve”</p>	<p>“Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.</p> <p>“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak [të ndaluar], konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.</p> <p>“Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet [e ndaluara], me qëllim përsheptimin e barazisë në fushën e punësimit” dhe “në edukim nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen në mënyrë të përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe masat e posaçme ndërpritin kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”.</p> <p>Këshilli i Ministrave, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Brendshëm janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për punësim.</p> <p>Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim.</p>	<p>“Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë [të mbrojtur], nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj”.</p>	<p>“Lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”.</p>		<p>Të qartësohet kuptimi i përfshirimit në lidhje me “dallimet në shpërblime dhe përfitime”;</p>
Bosnjë	<p>Masat e mëposhtme nuk duhet të konsiderohen diskriminuese, nëse:</p>	<p>Masat që “dalin nga zbatimi apo miratimi i masave të veçanta të përkohshme të hartuara</p>	<p>Masat të cilat “mbështeten në veçoritë që lidhen me</p>	<p>Masat nuk do të konsiderohen diskriminuese</p>	<p>Masa që “bazohen në</p>	<p>Të sqarohet formulimi i</p>

Juridiksioni	Përjashtime	Veprime pozitive	Kërkesa të vërteta dhe profesionale të domosdoshme	Ethos i bazuar te feja dhe besimi	Kombësia	Rekomandime
Hercegovinë	<p>“ato përkufizojnë moshën maksimale si më të përshtatshmen për përfundimin e marrëdhënies së punës dhe përcaktimin e moshës si kusht për daljen në pension”;</p> <p>“vendosja në një pozitë më pak të favorshme ndërsa përkufizon të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia familjare kur përkufizohet në Ligj, dhe sidomos me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, që duhet justifikuar me një qëllim të përligjur, mbrojtjen e moralit publik, së bashku me favorizimin e martesës në përputhje me dispozitat e ligjit për familjen”;</p>	<p>për të parandaluar apo kompensuar dëmet e pësuar nga personat në bazë të argumenteve [të mbrojtur] sidomos pjesëtarë të grupeve të cënueshme, si persona me aftësi të kufizuara, anëtarë të pakicave kombëtare, gratë, gratë shtatzëna, fëmijët, të rinjtë, të moshuarit dhe persona të tjerë të të përjashtuar në shoqëri, viktime civile të luftës, viktime në procedime penale, persona të zhvendosur, refugjatë dhe azilkërkues; d.m.th të mundësohet pjesëmarrja e plotë e tyre në të gjitha sferat e jetës”</p>	<p>argumente [të mbrojtur] kur në rrethana të kufizuara për shkak të natyrës së veprimtarive konkrete profesionale apo në kontekstin në të cilin zbatohen, këto veçori përfaqësojnë kushtin real dhe përcaktues në lidhje me zgjedhjen e profesionit. Ky përjashtim do të jetë subjekt i shqyrtimeve të herëpashershme”</p>	<p>“kur përcaktojnë një marrëdhënie punësimi, anëtarësim, dhe marrjen e veprimeve që janë në përputhje me predikimin dhe funksionimin e kishave dhe bashkësive fetare të regjistruara në BH, dhe organizata të tjera publike ose private që funksionojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, nëse kërkohet nga doktrina, bindjet apo qëllime fetare”</p> <p>Masa që “mbështeten në dallimin, përjashtimin apo dhënien përparësi në marrëdhënie punësimi si personel i një institucioni, që bëhen në përputhje me doktrinat, presupozimet bazë, dogmat, bindjet dhe mësimin e besimit apo fesë besimit, duke patur në mend se çdo dallim, përjashtim apo dhënie përparësi bëhet me ndërgjegje me qëllim që të mos dëmtohen ndjenjat fetare të anëtarëve të atij besimi apo asaj feje”</p>	<p>shtetësinë në mënyrën e parashikuar në Ligj”</p>	<p>dispozitës që i referohet përjashtimit në lidhje me pjesëtarët e stafit të disa institucioneve .</p>
Kroacia	<p>Vendosja në një pozitë më pak të favorshme nuk do të gjykohej diskriminim në rastet e mëposhtme: “kur kjo sjellje parashikohet në ligj për ruajtjen e shëndetit dhe për parandalimin e veprave penale dhe shkeljeve të tjera, dhe kur mjetet e përdorura janë të duhura dhe të domosdoshme për arritjen e qëllimit; “privilegjimi i grave shtatzëna, fëmijëve, të rinjve, më të moshuarve, personave me përgjegjësi përkujdesëse që i përmbushin rregullisht detyrat e tyre përkujdesëse, dhe personave me aftësi të kufizuara me qëllim mbrojtjen e tyre, kur kjo sjellje bazohet në dispozitat e ligjit, rregulloret, programet</p>	<p>“Veprim pozitiv, d.m.th kur kjo sjellje mbështetet në dispozitat e ligjeve, akteve nënligjore, programeve, masave dhe vendimeve me qëllim përmirësimin e statusit të grupeve etnike, fetare, gjuhësore apo pakicave të tjera apo grupe të tjera qytetarësh apo personash të diskriminuar për shkak të argumenteve [të mbrojtura]”</p>	<p>Vendosja në pozitë më pak të favorshme “në lidhje me një vend pune të veçantë, kur natyra e kësaj pune është e tillë apo kur puna kryhet në kushte të tilla që karakterizohen e saj që lidhen me ndonjë argument [të mbrojtur] paraqesin një kusht aktual dhe përcaktues për kryerjen e asaj pune, me kusht që qëllimi për ta arritur të jetë i justifikuar dhe kushti të jetë i duhur”</p>	<p>Vendosja në pozitë më pak të favorshme “në lidhje me veprimtaritë e punës, anëtarësimin dhe veprimin në përputhje me kodin dhe misionin e një kishë dhe bashkësi fetare të regjistruar në Regjistrin e Bashkësive Fetare të Republikës së Kroacisë, dhe çdo organizatë publike dhe private që vepron në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, nëse kjo kërkohet nga doktrina bindjet dhe</p>	<p>Vendosja në pozitë më pak të favorshme “në bazë të argumentit të kombësisë sipas rregulloreve të veçanta”</p>	

Juridiksioni	Përrjashtime	Veprime pozitive	Kërkesa të vërteta dhe profesionale të domosdoshme	Ethos i bazuar te feja dhe besimi	Kombësia	Rekomandime
	dhe masat në bazë të tyre”; “për shkak të moshës dhe seksit në përcaktimin e primeve të sigurimit, sasisë së sigurimit dhe kushteve të tjera të sigurimit në përputhje me të dhëna të sakta statistikore dhe rregullat për llogaritjen statistikore, në të cilin rast kostot që lidhen me shtazanimë dhe amësinë mund të mos i justifikojnë dallimet”; “fiksimi i kushteve minimale të moshës dhe/ose përvojës profesionale dhe/ose limitit të nivelit të arsimit për akses në një punësim të caktuar ose për të marrë avantazhe të tjera të lidhura me punësimin kur parashikohet në rregullore të veçanta”; “fiksimi i një moshe të përshtatshme maksimale si arsye për ndërprerjen e punësimit dhe përshkrimi i një moshe të caktuar si kusht për marrjen e pensionit të duhur”; “vendosja në një pozitë më pak të favorshme kur rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve që lindin për shkak të marrëdhënieve familjare kur parashikohet me ligj, në veçanti me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të cilat duhet të justifikohen nga një qëllim i përligjur, mbrojtje e moralitetit publik dhe favorizimi i martesës në përputhje me dispozitat e Aktit të Familjes”			objektivat fetare”		
